

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësve A., E. dhe M. G. nga Prishtina, të cilët i përfaqëson e autorizuar V. M.-B., avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson avokati publik komunal në Prishtinë Q. Ç., për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1017/2009 datë 16.11.2009, në seancën e mbajtur më 19.4.2012, mori këtë

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i të paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1017/2009 datë 16.11.2009 dhe ai i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.2710/2008 datë 28.8.2009, prishen dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1017/2009 datë 16.11.2009, është refuzuar ankesa e të paditurës si e pabazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.2710/2008 datë 28.8.2009, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe është vërtetuar se paditësit janë bashkëpronarë të pjesës së paluajtshmërisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale nr.145, me kulturë kullosë e klasit të IV, e regjistruar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL.71914050-00562, zona kadastrale Matiçan, në sipërfaqe prej 7500 m², në kufijtë e drejtë si vijon: prej pikës 1-2 në gjatësi prej 8.28 m; prej pikës 2-3 në gjatësi prej 19.91 m; prej pikës 3-4 në gjatësi prej 19.12 m; prej pikës 4-5 në gjatësi prej 29.27 m; prej pikës 5-6 në gjatësi prej 14.70 m; prej pikës 6-7 në gjatësi prej 9.29 m; prej pikës 7-8 në gjatësi prej 16.35 m; prej pikës 8-9 në gjatësi prej 20.15 m; prej pikës 9-10 në gjatësi prej 45.92 m; prej pikës 10-11 në gjatësi prej 32.13 m; prej pikës 11-12 në gjatësi prej 20.30 m; prej pikës 12-13 në gjatësi prej 32.30 m; prej pikës 13-14 në gjatësi prej 21.10 m; prej pikës 14-15 në gjatësi prej 17.52 m dhe prej pikës 15.1 në gjatësi prej 98.87 m. Me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura Komuna e Prishtinës që paditësve t'ua njohë të drejtën nga pika I e dispozitivit. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësve t'ua paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 342,80 €.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët të ndryshohen, ashtu që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve si e pabazuar ose të njëjtat t'i prishë dhe shkresat e lëndës t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se Komisioni për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësore të krijuara nga uzurpimi i tokave në pronësinë shoqërore, të KK Prishtinë, nga paraardhësi i paditësve tani i ndjeri I. G. nga Matigan, me aktvendimin nr.1487 datë 10.12.1963, ka marrë parcelën kadastrale nr.3/309/3, me kulturë arë, në sipërfaqe prej 0,75 ha. Sekretariati i atëhershëm financiar i Krahinës Autonome të Kosovës, me aktvendimin nr.8218 datë 31.3.1964 ka refuzuar ankesën e paraardhësit të paditësve dhe ka vërtetuar aktvendimin e cekur më lart. Me aktvendimin nr.1487 datë 9.7.1972 të Komisionit të cekur më lart, i është lejuar tani të ndjerit I. G. revidimi i aktvendimit të plotfuqishëm në procedurën e komisionit për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore të krijuara nga uzurpimi i tokave në pronësinë shoqërore, është anuluar aktvendimi në procedurën administrative dhe i është njohur e drejta e pronësisë në tokën e uzurpuar, si dhe me pikën V të dispozitivit të aktvendimit të cekur është detyruar Drejtoria Gjeodete Komunale në Prishtinë, me të hyrë në fuqi të këtij aktvendimi ta regjistrojë tokën kontestuese në listën poseduese të palës dhe të shlyejë atë nga lista nr.142, të pronësisë shoqërore në KK Matigan.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, ngase, tani të ndjerit I. G., me aktvendimin e plotfuqishëm të Komisionit për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Juridike Pronësore, i është njohur e drejta e pronësisë në pjesën e paluajtshmërisë lëndore si dhe e drejta e regjistrimit të saj në librat kadastrale në emrin e vet, i cili aktvendim përmban bazën e vlefshme juridike për fitimin e të drejtës pronësore në paluajtshmërinë lëndore, ndërsa paditësit janë të vetmit trashëgimtarë të pasurisë trashëgimore të tani të ndjerit I., dhe mbi këtë bazë në këtë kontest gjyqësor kanë legjitimacionin aktiv për të qenë palë në procedurë dhe kanë të drejtën që të kërkojnë njohjen e së drejtës së pronësisë kontestuese mbi këtë bazë, e pastaj ka vendosur si në dispozitiv të atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës së të paditurës, në tërësi ka pranuar konstatimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se babai i paditësve paluajtshmërinë kontestuese e ka fituar në pajtim me dispozitën e nenit 20 par. 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Bazë Pronësore-juridike, ndërsa paditësit si trashëgimtarë ligjorë të rendit të parë të trashëgimisë kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë në pajtim me dispozitat e nenit 20 par. 1 lidhur me nenin 28 par. 5 të Ligjit të cekur më lart.

Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund të pranojë një qëndrim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike, për të cilën arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilën arsye u deshtë të prishen aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë.

Trashëgimia lind në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit. Lëndë e trashëgimisë janë të gjitha të drejtat pronësore, të cilat trashëgimlënësi ka mundur, për së gjalli, me punë juridike t'i kalojë te personat e tjerë. Gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë vërtetuar nëse paraardhësi i paditësve ka qenë pronarë i patundshmërisë kontestuese. Kjo Gjykatë shton se paraardhësit e paditësve me aktvendimin nr. 1487 datë 10.12.1963 i është marrë parcela kadastrale nr. 3/309/3, me kulturë arë, në sipërfaqe prej 0,75 ha i cili aktvendim është bërë i plotfuqishëm, ngase me aktvendimin nr. 03 8218 datë 31.3.1964 është refuzuar ankesa e tani të ndjerit I. G. dhe është vërtetuar aktvendimi i cekur.

Aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK, ngase në arsyetimin e aktgjykimit ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është cekur se me aktvendimin e plotfuqishëm të Komisionit për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Juridike, - Pronësore tani të ndjerit I. G. i është njohur e drejta e pronësisë në pjesën e palujtshmërisë lëndore, si dhe e drejta e regjistrimit të saj në librat kadastrale në emrin e vet, ndërsa, nuk ka prova se aktvendimi i cekur është i plotfuqishëm. Kundër aktvendimit nr. 1487 datë 9.7.1972 të Komisionit për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësore të krijuara nga uzurpimi në pronësinë shoqërore, pala e pakënaqur ka pasur të drejtë ankese pranë Drejtorisë për punë juridike – pronësore dhe të përgjithshme në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktvendimit, ndërsa gjykatat e instancës më të ulët me asnjë provë nuk kanë vërtetuar nëse aktvendimi i cekur është bërë i plotfuqishëm, andaj konstatimi se aktvendimi është i plotfuqishëm, është në kundërshtim me përmbajtjen e aktvendimit i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar, nëse paraardhësi i paditësve ka zhvilluar kontest administrativ lidhur me bartjen e të drejtës së pronësisë nga data 9.7.1972 (data e aktvendimit), e deri në vitin 2006 kur i njëjti ka vdekur. Nga mendimi i ekspertit të gjeodezisë datë 11.8.2009, del se ngastra kadastrale nr. 3/309/35, sipas kadastrit përshkrues ka të bëjë me pjesën e ngastrës kadastrale nr. 145, e cila është formuar me matjet aerofotogrametrike të vitit 1972 dhe e cila nuk ka pësuar asnjë ndryshim deri më tani. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është cekur se me aktvendimin nr. 1487 datë 9.7.1972, tani të ndjerit I. G., Komisioni për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësore të krijuara nga uzurpimi i tokave në pronësinë shoqërore, ia ka njohur të drejtën e pronësisë në tokën e uzurpuar, e cila ka qenë e evidentuar si ngatër kadastrale me nr. 3/209/3, ndërsa eksperti i gjeodezisë ka konstatuar se vendi kontestues është ngastra kadastrale nr. 3/309/35. Lidhur me këto fakte kontestuese gjykata e shkallës së parë nuk ka siguruar historiatin e ngastrës kadastrale nr. 145, ZK Matičan, Komuna e Prishtinës, ndërsa sipas ekspertizës tipi i pronës është shoqërore.

Kjo Gjykatë shton se, në rastin konkret aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë kontradiktore me vetveten, sepse gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësit kanë fituar të drejtën e pronësisë në bazë të nenit 20 par. 2 lidhur me nenin 28 par. 5 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore-Juridike, ndërsa, neni 28 par. 5 i Ligjit të cituar parasheh se trashëgimtarët bëhen mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me keqbesim, e trashëgimtarët këtë nuk e kanë ditur as që kanë mund ta dinë, kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ecë nga momenti i hapjes së trashëgimisë.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykimin e mënjanojë të metat e sipërpërmendura, të vërtetojë bazën juridike të fitimit të pronësisë të paditësve, të vërtetojë nëse aktvendimi i Komisionit të cekur më lartë është i plotfuqishëm, nëse është zhvilluar procedurë administrative lidhur me bartjen e të drejtës së pronësisë, të caktojë ekspertizën nga ana e ekspertit të lëmisë përkatëse lidhur me historiatin e ngastrës kadastrale kontestuese dhe pas vërtetimit të këtyre fakteve, duke pasur parasysh edhe thëniet tjera të revizionit të marrë një vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e me zbatimin e nenit 195 par 1 pika (c) të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev I.nr.12/2010 datë 19.4.2012

Kryetarja e kolegjit
Emine Kaçiku